

**VENDIM****Nr. 1043, datë 16.12.2015**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 9, të nenit 25, pas fjalëve “... dokumenti i lejes ...” shtohen “... sipas shtojcës C të këtij vendimi ...”.

2. Në tekstin e shtojcës C të rregullores, fjalët “Kryetari i bashkisë/KKT” zëvendësohen me “Kryetari i bashkisë/Sekretari i KKT-së”.

3. Në nenin 45, shkronja “c” zëvendësohet me fjalitë, si më poshtë vijon:

“Për objektet mbi 6 kate, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, leja e ndërtimit jepet nga autoriteti vendor përgjegjës pas kontrollit paraprak pa vërejtje të Këshillit Kombëtar të Territorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve, lidhur me përputhshmërinë me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit në proces. Me kalimin e afatit 10-ditor, pa vërejtje nga Këshilli Kombëtar i Territorit, kontrolli i përputhshmërisë konsiderohet i përfunduar pozitivisht dhe kërkesa për leje shqyrtohet nga autoriteti vendor përgjegjës.

Ngarkohen ZVRPP-të përkatëse për të pasqyruar/regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme ndryshimet e ndodhura në kategoritë e resurseve, që vijnë si pasojë e miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit sipas këtij neni dhe vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e zonave të urbanizuara të

territorit. Certifikata e pronësisë e përditësuar si më sipër i lëshohet pronarit të pasurisë së paluajtshme, me kërkesë të këtij të fundit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1044, datë 16.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
MARRËVESHJES ME SHKËMBIM
NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS
POPULLORE TË KINËS, “MBI
RECIPROCITETIN E GODINAVE KU
AKOMODOHEN PËRFAQËSIA
DIPLOMATIKE E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, NË PEKIN, DHE
PËRFAQËSIA DIPLOMATIKE E
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,
NË TIRANË”, NËNSHKRUAR MË
10.4.1960**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 8, shkronja “a”, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë, në Pekin, dhe përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë”, nënshkruar më 10.4.1960.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.